



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

**RELACION TEKNIK**

(KONTRATA NR.3)

Mirëmbajtje me performance rruga: "**Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun), Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja), Baks - Rrjoll, K.Bushat - Bisht Jugë**"

*Përshkrim i përgjithshëm.*

Aksi rrugor "**Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun)**" (27.5 km) është një segment rrugor prej vitesh pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Vetem pjesa D/Plazh - Viln (1 km) është shtuar me VKM Nr. 600 në tetor të vitit 2021. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetin e Shkodrës me plazhin turistik të Velipojes. Segmenti klasifikohet në kategorinë C si rrugë interurbane dytesore, me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina 75 cm të paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml (me vije në mes) dhe 7 ml në segmentin e rikonstrktuar vitet e fundit nga FSHZH "**Harku i Bërdicës-Baks**". Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren fushor, i cili klasifikohet si segment pa mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja)**" (3.8 km) është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetin e Shkodrës me fshatin turistik të Shirokës. Segmenti klasifikohet në kategorinë C si rrugë interurbane dytesore, me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me bordure në njërën anë dhe kunete dhe trotuar në anën tjetër. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml (me vije në mes). Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të ulët buze malit të Taraboshit, i cili nuk klasifikohet si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**Baks- Rrjoll**" (8 km) është një segment rrugor që do bëhet pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër me VKM të re. Ky segment rrugor është një degezim i aksit "**Harku i Bërdicës-Velipojë (Vilun)**" përkrah në pikën e quajtur Baks, dhe shërben për të lidhur qytetin e Shkodrës me plazhin turistik të Rrjollit. Segmenti klasifikohet në kategorinë C si rrugë interurbane dytesore, me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me bankina 2x50cm të paasfaltuara. Gjeresia mesatare e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

pjesës kaluese të rrugës është 5-6 ml (me vije ne mes). Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren te ulet buze malit, i cili nuk klasifikohet si segment me mirëmbajtje dimërore.

Aksi rrugor "**K.Bushat - Bisht Jugë**" (10.1 km) është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetin e Vau Dejes me Plazhin e Velipojes. Segmenti klasifikohet i kategorisë C si rrugë interurbane dytesore , me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me bankina te pasafaltuara 2x50 cm. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 6 ml (me vije ne mes). Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër terren fushor, i cili nuk klasifikohet si segment me mirëmbajtje dimërore.

Me poshte parqiten ne forme tabelare segmentet qe perbejne kete kontrate.

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Harku Bërdicës - Velipojë - Vilun	27.5	42°01'55.3"	19°30'11.6"	41°51'54.7"	19°26'26.5"
2	Ura e Re e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja)	3.8	42°02'46.6"	19°29'09.0"	42°03'30.1"	19°27'36.6"
3	Baks - Rrjoll	8	41°55'01.1"	19°25'27.9"	41°51'40.0"	19°28'31.3"
4	K/Bushat - Bisht Jugë	10.1	41°58'50.8"	19°32'37.1"	41°55'40.0"	19°28'11.2"
<b>Shuma (km):</b>		<b>49.4</b>				

***Kushtet e inspektimit.***

Sot me datë 05.04.2024, në zbatim të Urdhërit të Brëndshëm Nr.113 datë 26.03.2024, kemi bërë inspektimin në terren të segmenteve rrugore "**Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun), Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja), Baks - Rrjoll, K.Bushat - Bisht Jugë**". Bazuar në urdhërin e brëndshëm për përllogaritjen e fondit limit, si objektivi i inspektimit tonë ka qënë konstatimi i gjëndjes aktuale të segmenteve rrugore në fjalë dhe përcaktimi i nevojave për punime rehabilitimi që do ketë ky segment gjatë 4 viteve të ardhshme (2025-2029) , me qëllim hartimin e preventivave për përllogaritjen e fondit limit të kontratës së ardhshme. Theksojmë se inspektimi jonë është vetëm i karakterit vizual.

***Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .***





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Gjendja e aksit rrugor "**Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun), Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja), Baks - Rrjoll, K.Bushat - Bisht Jugë**" ne pergjithesi është mesatare. Ne segmentin rrugor "**Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun)**" pjesa e pare "**Harku i Bërdicës – Baks**" eshte rikonstruktuar totalisht nga FSHZH ne pese vjecarin e fundit dhe eshte ne gjendje te mire, pavaresisht disa problematikave te guardrailave te cilat jane hequr dhe demtuar pjeserisht nga banoret e zones. Ndersa segmenti rrugor "**Baks – Velipojë**" eshte segment ne gjendje mesatare me shtresa asfaltike te vjeteruara, ku sidomos ne pjesen nga Pulaj e deri ne Vilun kemi pasur demtime te shtresave rrugore nga punimet qe jane bere per kanalizimet e zones. Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të mirëmbajtjes vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike. Gjithashtu evidentohen dhe riparimi i disa mureve apo kanale anesore.. Ka një përmirësim të dukshem të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrone apo përvijues anësorë. Gjithashtu nuk rezulton një shtim i barrierave mbrojtëse metalike krysisht në pika te rrezikshme. Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon ne disa zona jo shume qendrushme ku vihen re cedime te shtresave te, vërehet së aksi ka nevoja të metëjshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve rrugore që përmendëm më sipër, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme. Duhet menjëhere pas lidhjes së kontratës së mirëmbajtjes të kryhen disa punime rehabilitimi në mënyrë që rruga të sillet në një standart të pranueshëm për qarkullimin e mjeteve, dhe gjatë zbatimit të kontratës së ardhshme të realizohen punime rehabilituse periodike për ta mbajtur në kushte të duhura teknike për qarkullimin e mjeteve.

***Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.***

- Ne aksin rrugor "**Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun)**" vihet re edhe disa cedime te shtresave rrugore ne vende te caktuara si dhe amortizim ose demtim te shtresave asfaltike kryesisht ne segmentin "**Pulaj -Velipojë (Vilun)**", ne te cilin jane perqendruar dhe sasia me e madhe riveshjeve te kontrates. Ne lidhje me sinjalistiken mund te themi se ne pergjithesi eshte e plotesuar por ka nevojë per shtimin e saj. Gjendja e shtresave asfaltike te pjeses tjeter **Harku i Bërdicës -Baks** eshte ne gjendje pothuajse mesatare ose e mire. Po keshtu edhe per vijejimet mund te themi te njeten gje. Megjithëse ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe barrierave mbrojtëse metalike, përsëri kemi evidentuar nevoja që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndatjes së punimeve. Ne lidhje me fugat e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

urave është menduar të zëvendësohen me të reja sidomos fugat e dy urave në segmentin Baks Velipoje. Në lidhje me vijëzimet, rezulton se pjesa më e madhe e aksit është momentalisht e vijëzuar ose në proces vijëzimi. Standarti i përdorur masivisht për rrugët e kategorisë C për vijëzime është : 2 vijat anësore janë të realizuara me vijë me trashësi 15cm. Të njëjtin standart kemi ndjekur edhe në parashikimin e vijëzimeve që do realizohen katër vitet e ardhshme. Dy vijat anësore janë shumeziar me koeficient 1 ndërsa vija e mesit me koeficient 0.7. Vendodhjet përkatëse të punimeve janë të specifikuara në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

- Në aksin rrugor "**Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja)**" vihet re edhe disa cedime të shtresave rrugore në vende të caktuara si dhe amortizim ose demtim të shtresave asfaltike për të cilat është menduar një sasi riveshje. Në lidhje me sinjalistikën mund të themi se në përgjithësi është e plotësuar por ka nevojë për shtimin e saj. Po kështu edhe për vijëzimet mund të themi të njëjtën gjë. Megjithatë ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale, përsëri kemi evidentuar nevojën që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve. Vendodhjet përkatëse të punimeve janë të specifikuara në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

- Në aksin rrugor "**Baks – Rrjoll**" vihet re demtime të shtresave asfaltike për të cilat është menduar një sasi riveshje. Në lidhje me sinjalistikën mund të themi se në përgjithësi ka shumë nevojë për zëvendësimin dhe shtimin e saj. Po kështu edhe për vijëzimet mund të themi të njëjtën gjë. Megjithatë ky segment rrugor ka shënja të përmirësimit të dukshëm të sinjalistikës vertikale, përsëri kemi evidentuar nevojën që do ketë aksi katër vitet e ardhshme, të cilat janë evidentuar më me saktësi në tabelat e shpërndarjes së punimeve. Vendodhjet përkatëse të punimeve janë të specifikuara në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

- Aksi rrugor "**K.Bushat - Bisht Jugë**" është një segment rrugor që nuk është bërë ndonjë investim për rikonstruksion prej shumë kohësh. Ka nevojë të shumta për nderhyrje në riparime të shtresave rrugore, sinjalistikës horizontale dhe vertikale dhe elementeve të tjera rrugore. Vendodhjet përkatëse të punimeve janë të specifikuara në tabelat e shpërndarjes së volumeve.

***Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.***





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasi të këtyre punimeve të paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet më të lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave të rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit periodike.

**Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :**

*Foto nga inspektimi në terren.*

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Më poshtë fotot e realizuara në terren :





---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**  
**DREJTORIA E RAJONIT VERIOR**



**GRUPI I PUNËS :**

